



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E DREJTA E KADASTRAVE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta e Kadastrave
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	viti i II-të, semestri i III-të
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Ligjërata: e enjte (ora 13 ⁰⁰) Ushtrime: /// Asistent: ///
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Afet MAMUTI
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	E drejta e kadastrave bën pjesë në grupin e lëndëve civile e cila është paraparë në programin e lëndëve të fushës së drejtësisë me qëllim që studentët në mënyrë të veçantë të informohen për kuptimin e sendeve, respektivisht të sendeve të paluajtshme, pastaj për kadastrin, regjistrat për pronën e paluajtshme, hartografinë, dhe të tjera. Poashtu gjatë studimit të kësaj lënde do të trajthen dhe sistemet e regjistrave të tokës nëpër botë dhe procedura për regjistrimin e të drejtave mbi sendet e paluajtshme. Rëndësi të veçantë do të kushtohet edhe subjekteve që merren me matjet kadastrale, licencimit të kompanive dhe gjeodetëve për kryerjen e matjeve kadastrale si dhe kompetencat dhe organizimin e AKK dhe ZKK.
Qëllimet e lëndës:	Toka paraqet njërin nga sendet kryesore të paluajtshme. Vlera e saj vazhdimisht vjen duke u rritur në çdo vend të botës për shkak të rritjes së popullsisë dhe pandryshueshmërisë së sipërfaqes së saj. Me qëllim që të sigurohet ruajtja dhe kujdesi ndaj tokës kërkohet menaxhim dhe administrim i kujdesshëm i saj. Prona në përgjithësi dhe paluajtshmëritë në veçanti gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ligjet e vendit dhe ato ndërkomëtare. Kjo vërehet edhe në Kosovë ku çdo parcelë është e regjistruar në regjistrat kadastral me të gjitha të dhënat konkrete grafike dhe gjeodezike. Të gjitha të dhënat hartografike dhe pronësore për secilën parcelë mund të gjinden në bazën e të dhënave digjitale. Të gjitha këto të dhëna do shërbejnë që studentët,

	informacionet e marra nga kjo fushë t'i përdorin me saktësi të lartë me rastin e planifikimit hapësinor, planifikimit urban, rregullimet e tokave dhe ndërtimet inxhinierë të ulëta dhe të larta.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët pas përfundimit të këtij kursi do të jenë në gjendje që të ofrojnë ndihmë dhe këshilla juridike të sakta dhe të shpejta në fushën e kadastrës dhe administrimin e tokës. Do jenë të aftë të bëjnë rindërtimin e të dhënave kadastrale në rastet e mospërputhjes së të dhënave kadastrale me gjendjen faktike në terren duke kompletuar të dhënat mbi pronësinë mbi paluajtshmërinë e caktuar, në bazë të së cilës më pas caktohet dhe baza për caktimin e tatimit, planifikimin dhe shfrytëzimin e tokës, zhvillimin e infrastrukturës etj.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënësit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Kollokfume,seminare	1	1	
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)			
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali			30
Metodologjia e mësimdhënies:	Kursi do të organizohet përmes ligjëratave, seminareve dhe shqyrtimin e rasteve. <i>Ligjëratat</i> - mbajtja e ligjëratave do të bëhet në forme verbale e përcjell me poëer point, interaktive –bashkëbisedim me studentët, diskutim i çështjeve praktike dhe instruksione për student për çështjet nga programi mësimor. <i>Raste studimi-simulimi</i>: gjatë kursit studentët do të kenë punë praktike të cilat do të jenë në formën e rasteve të studimit që mbahen në klasë. Studentët do të ngarkohen edhe me raste studimi të cilat duhet të punohen si detyrë shtëpie dhe të njëjtin ta prezantojn përpara profesorit dhe kolegëve. Rastet e studimit përbëhen nga formulime me shkrim të rasteve nga praktika dhe dhënia për detyrë studentëve për të zgjidhur rastin e tillë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Hartimi i shkresave në klasë ose detyrë shtëpie. Simulimi i rasteve paraqet formë praktike përmes së cilës studentët aftësohen në ushtrime praktike duke simuluar raste dhe marrë rolin e palëve dhe organeve tjera në çështje që kanë të bëjnë me regjistrimin dhe fitimin e një të drejte mbi sendet e paluajtshme.		

Metodat e vlerësimit:	Testi i parë: 30 pikë Testi i dytë: 30 pikë Detyrat e shtëpisë: 10 pikë (pregatitja e punimeve seminarike dhe prezentimi) Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në klasë: 10 pikë Provimi përfundimtar: 80 pikë Totali: 100 pikë. Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 51-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Pikët nga 50 e poshtë nuk mbërrijnë notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	- “Kadastru 2014” – Vizion për të ardhmen e sistemeve kadastrale – Jürg Kaufmann & Daniel Steudler, Prishtinë, 2004. - Administrimi i Tokave dhe Kadastru në Kosovë 2000-2014, Prof. Dr. Murat Meha, Prishtinë, 2013. - E Drejta Sendore – Prof. Dr. Abdulla Aliu, Prishtinë, 2014. - Procedura për Regjistrimin e Pronës dhe Shërbimet në Kadastër, Murat Meha, Fredrik Steiëer, Hajzer Bublaku, Prishtinë 2012.
Literatura shtesë:	Ligji mbi Hipotekat Ligji për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme Ligji për Kadastër Ligji për sistemin e adresave Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në të drejtën kadastrale, Kuptimi i të drejtës kadastrale, Kuptimi i regjistrave të tokës, Baza juridike – legjislacioni
<i>Java e dytë:</i>	E Drejta Sendore Kuptimi i Sendeve Sendet e Paluajtshme
<i>Java e tretë:</i>	Parimet e të Drejtës Kadastrale Objekti i studimit i të drejtës kadastrale Subjektet e të Drejtës Kadastrale
<i>Java e katërt:</i>	Pronësia Posedimi Hipoteka
<i>Java e pestë:</i>	Sistemet e librave të tokës, Sistemi Austriako – Gjerman, Sistemi Francez, Sistemi Australian apo Sistemi i Torensit Sistemi i tapive, Tapia, Librat e intabulimit
<i>Java e gjashtë:</i>	FIG – Federata Ndërkombëtare për Gjeodezi OICRF – Zyra Ndërkombëtare për Kadastër dhe Regjistrim të

	Tokës,
Java e shtatë:	Sistemet Kadastrale në Kosovë; Sistemi KCID (Kosovo Cadastral Interim Database) Sistemi RDPP (Regjistrimi i të Drejtës mbi Pronën e Paluajtshme) Sistemi SIKTK (Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokat në Kosovë)
Java e tetë:	Kompetencat e: - Agjensis Kadastrale të Kosovës: - Licencimi i kompanive dhe gjeodetëve për kryerjen e matjeve Kadastrale, - Mbikqyrja e të gjitha aktiviteteve të kryera nga Zyrtar Kadastrale të Kosovës, kompanitë gjeodezike dhe gjeodetët e licencuar; - Zyrtar Kadastrale të Kosovës, - Kompanive gjeodezike, - Gjeodetëve të licencuar.
Java e nëntë:	KOLOKFIUMI I
Java e dhjetë:	Rindërtimi i Informacioneve Kadastrale -Krijimi i Informacioneve Kadastrale për Ndërtesa
Java e njëmbëdhjetë:	Regjistrimi i Adresave në bazë të Ligjit për Sistemin e Adresave
Java e dymbëdhjetë:	Plotësimi i Gjeoinformacionit Hapësinor të Kosovës -Përpilimi i Hartës Topografike
Java e trembëdhjetë:	Regjistrimi i të Drejtave mbi Paluajtshmërinë nëpër botë; Regjistrimi i të Drejtave mbi Paluajtshmërinë në Kosovë;
Java e katërbëdhjetë:	Bazat Juridike për Fitimin e të Drejtave mbi Sendet e Paluajtshme
Java e pesëmbëdhjetë:	KOLOKFIUMI II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
a)	Gjatë vijimit të kursit duhet të ruhet integriteti personal dhe akademik i mësimeve dhe studentit;
b)	Pjesëmarrja në ligjërata është e obligueshme për studentët, ndërsa mospjesëmarrja në ligjërata do të tërheq pasoja në përputhje me dispozitat që dalin nga Statuti i Universitetit (çdo mungesë e paarsyeshme reflektohet në vlerësimin përfundimtar, me përjashtim të rasteve të arsyeshme);
c)	Evidentimi i rregullsisë së vijimit në ligjërata, pjesëmarrjes në aktivitete dhe diskutime lidhur me çështjet që janë objekt ligjërimi, do të vlerësohen nga Profesori i lëndës.
d)	Studentët duhet ti përmbushin detyrimet e dhëna gjatë punës praktike dhe detyrave të shtëpis. Mungesa e përmbushjes së detyrimeve reflektohet në kalueshmërinë e provimit.
e)	Studentët duhet ti përmbahen rregullave disiplinore të mbarëvajtjes së ligjëratave, prezenteve praktike, kolokfiumit dhe provimit.
Plagjiatura dhe format e ndryshme të kopjimit janë të ndaluara dhe reflektohen në vlerësimin negativ për studentin dhe ndëshkime tjera sipas rregullave përkatëse ligjore.	